



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:163865

Datë: 12.02.2025

Numri i dokumentit: 06843726

**2024:175257**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Fitore Krivanjeva-Daci, me procesmbajtëse Egzona Livoreka-zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.H nga Ferizaj, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1, të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.Nr.595/24, të datës 20.06.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë 27.01.2025, në prani të Prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, përfaqësuesit të të dëmtuarës KEDS–Distrikti në Ferizaj, Trëndelina Kryeziu dhe të akuzuarit G.H, më datë 29.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.02.2025, përpiloi me shkrim këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **I akuzuari:**

**G.H**, i lindur me datë 24.02.1988 në Ferizaj, nga babai B... dhe nëna M.... e gjinisë Z...., me vendbanim në rrugën “.....”, komuna Ferizaj, i martuar, prind i katër fëmijëve, ka të përfunduar shkollën e mesme, me numër personal “.....”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Në kuptim të nenit 363 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të KPPK-së:**

### **LIROHET NGA AKUZA**

#### **Sepse:**

Prej datës së pa vërtetuar e deri më datën 05.05.2023, tek lokali afarist-butik i cili gjendet në rrugën “Ahmet Kaçiku”, afër nën kalimit në Ferizaj, i pandehuri G.H ka siguruar shërbime të energjisë elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit duke shmangur pagesën për këto shërbime, në atë mënyrë që njësorit elektrik me numër: 62267292, i janë manipuluar pllombat, të cilat i ka pasur të hapura dhe prapë të mbyllura, ku në brendi të njëisorit, komisioni i kalibrimimit ka konstatuar se sistemi i fazës së parë (L1) dhe sistemi i fazës së dytë (L2) janë të eliminuar, ku si pasojë e kësaj njësjori elektrik nuk ka regjistruar energji elektrike në këto dy sisteme të fazave, gjendje kjo e konstatuar nga zyrtarët e kalibrimimit, me të cilat veprime të dëmtuarës kompanisë “KEDS” i ka shkaktuar dëm material në shumën të përgjithshme prej 2,333.97 €-,

**Pasi që nuk është provuar se ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1, të KPRK-së.**

- E dëmtuara KEDS-Distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- Shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e paushallit gjyqësor bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## **A r s y e t i m i**

### **Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP/II.nr.595/24 të datës 20.06.2024, e ka ngarkuar të akuzuarin G.H me vendbanim në rrugën “.....”, në Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1, të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 08.08.2024, ku i akuzuari në këtë shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza.

Gjykata caktoi seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 03.12.2024, 17.12.2024, 27.01.2025, në të cilat shqyrtime të pranishëm ishin prokurori i shtetit Albert Zejnullahu, përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS – Trëndelina Kryeziu dhe i akuzuari G.H.

Gjyqtarja e vetme gjyquese e udhëzoi të akuzuarin për të drejtat dhe detyrimet e tij në kuptim të nenit 319 paragrafi 1 dhe 2, të KPPK-së. Pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me nenin 321 paragrafi 1, të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë përsëri që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor është deklaruar i pafajshëm.

### **Fjala përfundimtare e palëve**

Prokurori i shtetit Albert Zejnullahu, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë administruar prova personale dhe materiale me të cilat është vërtetuar se i akuzuari G.H ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga nenin 314 paragrafi 1, të KPRK-së. Kjo më së miri u vërtetua nga dëgjimi i dëshmitareve Sh.M dhe G.R, të cilët në mënyre kronologjike kanë paraqitur para gjykatës të gjeturat në njësinë elektrik. Nuk është kontestuese se i akuzuari ka qenë në shfrytëzim të lokalit në të cilin lokal ka qenë i vendosur njësinë elektrik me numër 62267292, nuk është kontestuese se këtë lokal e ka pasur me qira si dhe fare nuk është kontestuese se në këtë njësinë ka pasur manipulime, kjo është vërtetuar nga prova materiale që është protokoll i verifikimit të njësinës elektrik në qendrën e kalibrimit i datës 13.01.2023, procesverbali i ekzaminimit të këtij njësinës dt.04.03.2023 dhe si provë më bindëse se ky njësinë ka qenë i manipuluar pikërisht në kohën kur i akuzuari e ka pasur në shfrytëzim është konstatimi i datës 03.12.2024 në të cilin janë përcaktuar datat dhe ora e saktë e manipulimit të këtij njësinës, e qe kjo provë është në kundërshtim me mbrojtjen e të akuzuarit i cili edhe sot është kontradiktor në mbrojtjen e dhënë në prokurori e po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor, pikërisht ai ka qenë i interesuar që ti dijë datat e sakta të manipulimeve e kjo është vërtetuar me dëshminë që cekem tani.

Vepra penale vjedhje e shërbimeve për të përmbushur elementet e saj duhet që të përmbushen këto elemente që janë: sigurimi i shërbimeve të cilat mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit e që në rastin konkret për të i ikur shpenzimeve janë bërë edhe ndërhyrje në këtë njësinë me c ‘rast energjia e shpenzuar është regjistruar me pak ose fare nuk është regjistruar.

Nga të gjitha këto të cekura më lartë kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoje konform ligjit pasi që është vërtetuar se i njëjti ka kryer këtë veprë penale, sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata të ketë parasysh të gjitha rrethanat, si rrethana rëndësuese,

mënyrën e kryerje, dashjen si dhe dëmin e shkaktuar ashtu që në sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit KEDS–Trëndelina Kryeziu në fjalën përfundimtare se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, i bashkëngjitet ndjekjes penale si dhe do të paraqesin kërkesë pasurore juridike në vlerën prej 2333.97 euro.

I akuzuari G.H në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk ka diçka tjetër për të shtuar përpos atyre që i ka cekur në mbrojtjen e tij, vetëm shton edhe faktin se ai lokal është butik për rroba dhe aty përpos dritave të vogla për ndriçim dhe klimës diçka tjetër në atë lokal nuk kemi. Pra, edhe njëherë deklaron se të jeni të sigurt 100% se unë këtë vepër penale nuk e kam kryer.

### **Mbrojtja e të akuzuarit**

I akuzuari G.H pas udhëzimeve të dhëna nga gjyqtarja e vetme gjykuese, në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 27.01.2025, ka deklaruar se nuk ka çka të deklaroj në lidhje me këtë çështje penale vetëm do të shton faktin se unë që nga fillimi këtë lokal e kam shfrytëzuar së bashku me dy vëllezërit e mi dhe prej datës 04.05.2024 dy vëllezërit e mi janë larguar nga lokali dhe ma kanë lënë të e shfrytëzoj veç vet dhe atë për shkak se unë kam kushte më të renda ekonomike. Unë asnjëherë nuk e kam prekur apo intervenuar në këtë njësor elektrik, për këtë ju betohem sepse unë me të ardhurat e atij lokali deri tani e kam mbajtur familjen, po ashtu nga ky lokal familjen e kanë mbajtur edhe dy vëllezërit dhe nuk kemi qenë të punësuar diku tjetër. Unë para disa dite kam kontaktuar me vëllain tim i cili tani ka shkuar në migrim dhe ai tha “me kujtohet se njëherë me është dashur të thërras një person që ka njohuri me energji elektrike sepse të gjithë telat e rrymës për shkak të tensionit të lartë kishin dalë nga vendi dhe ai ja paska rregulluar vëllait tim këtë problem”. Shton se nuk ka qenë në dijeni në lidhje me këtë problem të njësorit sepse siç e ceka edhe me lartë unë kam punuar me pagë tek vëllai, ku i njëjti më paguante nga 200 euro në muaj.

Deklaron se në lidhje me këtë çështje penale i kujtohet se ka dhënë deklaratë në prokurori dhe i përmbahet atyre deklarimeve. Shton se lokalin e kanë marrë me qira së bashku me vëllezërit dhe nuk kanë pasur të lidhur ndonjë kontratë për qiranë. Më datë 04.05.2020 kanë filluar punën në lokal. Shton se me vëllain e tij nuk ka pasur marrëveshje me shkrim, por i njëjti e ka paguar çdo muaj nga 200 euro dhe atë secili nga tre vëllezërit i kemi marrë nga 200 euro në muaj nga ai lokal. Marrëveshjen e qirasë e ka bërë ai së bashku me vëllain e tij Shkëlqimin i cili tani është jashtë vendit, marrëveshja ka qenë 600 euro në muaj.

Edhe njëherë potencon faktin se marrëveshjen e ka arritur ai së bashku me vëllain e tij, ku kanë dal për të pirë kafe me pronarin e lokalit dhe aty e kanë arritur marrëveshjen të tre. Shton se një pronarin e lokalit, ka kohë të gjatë që nuk e ka takuar pasi që i i njëjti gjendet ne Danimarkë. I kujtohet se në muajin nëntor të vitit 2020 e kanë pasur së bashku me vëllezërit në shfrytëzim lokalit.

Tutje deklaron se qiranë e lokalit e kanë paguar tre vëllezërit së bashku, pra unë dhe dy vëllezërit e mi, bile ka pasur raste kur nuk kemi mundur të e bëjmë shumën e mjaftueshme, kemi kërkuar edhe hua diku tjetër, por qiranë e kemi paguar bashkërisht. Shton se edhe rryma, edhe uji, mbeturinat edhe të gjitha shërbimet komunale gjithmonë kanë ardhur në emër të vëllait të tij Shkëlqimit, por ditën kur është bërë kontrolla nga ana e punëtorëve të KEDS ka rastisur të jetë në orarin e tij të punës, aty dhe për këtë arsye procesverbali është bërë në emrin e tij sepse atë ditë ai ishte në orar të punës.

### **Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor**

Pasi që i akuzuari, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën e ka ngarkuar aktakuza, gjykata ka bërë paraqitjen provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 360 paragrafi 1 dhe 2, të KPPK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë nga:

- Dëshmia e dëshmitarit SH.M
- Dëshmia e dëshmitarit G.R

### **Nga provat materiale:**

- Fatura: DFEHP2323601 e datës 11.07.2023;
- Kalkulimi i RH- Divizioni i Furnizimit- Sektori i rikthimit të humbjeve me nr.469418;
- Procesverbali me numër: 0033289 i datës 27.12.2022;
- Procesverbali nr.2069910 i datës 05.05.2023;
- Protokolli i verifikimit të njehsorit elektrik në Qendrën Laboratorike nr. KEDS-EL-F-LC-04 i datës 13.01.2023;
- Procesverbali i ekzaminimit të njehsorit elektrik- MINT i datës 04.03.2023 me nr.27/4;
- Konstatimi i datës 03.12.2024 nga qendra e kalibrimit;
- Dëftesat e pagesës;

- Transaksionet e konsumatorit dhe,
- Fotografitë nga vendi i ngjarjes.

### **Vlerësimi i provave të prezantuara në shqyrtim gjyqësor**

Në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata konform nenit 7 dhe 360, të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal, profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit, si dhe ato në favor të tij, duke i mundur të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

### **Vlerësimi i dëshmisë së dëshmitarit dhe provave materiale të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Fillimisht para se të vlerësohet dëshmia e dëshmitarëve dhe provat tjera materiale është e nevojshme që të qartësohet se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme faktet në vijim:

- Se i akuzuari është njëri nga shfrytëzuesit e lokalit të marrë me qira së bashku me vëllezërit;
- Se ka pasur dy ndërhyrje në njësinë elektrik dhe atë një më datë 17.11.2020 ora 10:27:43 dhe ndërhyrja tjetër më 17.11.2020 ora 10:36:21;

Gjyqtarja e vetme gjykuese tutje ka vazhduar me vlerësimin e dëshmisë së dëshmitarëve.

### **Dëshmia e dëshmitarëve**

Nga dëshmia e dëshmitarit Sh.M e dhënë në shqyrtimin gjyqësor më datë 03.12.2024, i cili ka deklaruar se punon në KEDS që nga viti 2009 ndërsa në sektorin përkatës–sektori i humbjeve punon që nga viti 2020. Detyrat e tij janë ndërrimi i njësorëve, kontroll dhe zhvendosje e njësorit kryesisht puna ime lidhet me punën në terren. Në terren për çdo ditë marrim urdhëresa nga eproret, por ka rast kur edhe dalim për kontroll rutinë.

Deklaron se rasti për të cilin është ftuar të dëshmoj i kujtohet, por nuk i kujtohet a kanë shkuar me urdhëresë apo për shkak të kontrollit rutinë, por i kujtohet se kanë shkuar për ta ndërruar njësinë elektrik dhe atë ka qenë së bashku me kolegun H.A. Shton se në rastin konkret kemi

shkuar për ndërrim të njësorit elektrik me urdhëresë të departamentit tonë. Kur kemi shkuar në vendin e ngjarjes tek konsumatori njësori i tij ka qenë elektronik dhe nuk kanë bërë ndërrimin për shkak se njësori elektronik ka dhënë një sinjal të quajtur MC, që do të thotë se njësori është i ngacmuar. Detyre e jona si njësi është vetëm ndërrimi i njësorit dhe asgjë me tepër, njësorin e vjetër e kemi marrë me veti dhe në vend të ngjarjes kemi përpiluar një procesverbal. Atë ditë dikush ka qenë në lokal dhe ja kanë prezantuar procesverbalin, por nuk i kujtohet kush ka qenë.

Tutje deklaron se njësori i vjetër ka qenë i llojit ISKRA viti i prodhimit 2012, ndërsa është vendosur njësori i llojit ISKRA i viti 2022. I njëjti nuk ka njohuri se nëse njësori i vitit 2012 është kontrolluar ndonjëherë, nga ai personalisht jo. Shton se njësori elektrik ka granacion 5 vite, pasi që e kanë hequr njësorin e kanë vendosur në qese speciale ku qesja blombohet dhe pastaj e kanë dorëzuar tek zyrat e KEDS, dhe këtu përfundon kompetenca e tyre në lidhje me këtë njësor. Sa i përket sinjalizimit që jep njësori elektrik kur ngacmohet, nuk e din nëse i njëjti njësor ka lajmëruar me herët për ngacmim.

Gjykata vlerësoi me kujdes deklarimin e dëshmitarit Sh.M dhe vëren se e njëjta është reale, e besueshme dhe në harmoni me shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë dhe me përshkrimin e vendit të ngjarjes, pasi që ngjarjen e përshkruan në mënyrë kronologjike dhe tejet bindëse.

I njëjti e përshkroi ngjarjen në hollësi se si kanë shkuar tek konsumatori për të bërë ndërrimin e njësorit elektrik, por nuk kanë mundur ta bëjnë pasi që njësori elektrik ka dhënë një sinjal të quajtur MC, që do të thotë se njësori ka qenë i ngacmuar dhe me këtë rast vetëm ka përpiluar një procesverbal dhe ja ka prezantuar personit që ka qenë në lokal.

Nga dëshmia e dëshmitarit G.R e dhënë në shqyrtimin gjyqësor më datë 03.12.2024, i cili ka deklaruar se punon në KEDS në këtë pozitë diku rreth 7 vite, në mesin e disa detyrave dhe përgjegjësive të tija, njëra prej tyre është ekzaminimi i njësorit elektrik dhe kontrollimi detaj i tyre që nënkupton hapja e njësorit, konstatimi i të gjeturave dhe keqpërdorimit, ndonjë dëmtim dhe kështu me radhë. Të gjithë njësor elektrik në qendrën tonë vijnë duke mos e ditur emrin dhe mbiemrin e konsumatorit e po ashtu as edhe shifrën e konsumatorit, ne i identifikojmë përmes numrit serik të tyre. Shton se njësorët janë të futur në qese dhe qesja është e blombuar. Komisioni për ekzaminim të njësorit elektrik nuk do të thotë që është i përhershëm sepse ato caktohen varësisht prej prioriteteve dhe caktohen nga përgjegjësi jonë, ndërsa përbehen prej 3 personave.

Në terma të përgjithshëm njësorët elektrik që vijën për ekzaminim, pas formimit të komisionit ne bëjmë kontrollimin detal të njësori elektrik, që nënkupton të gjitha të gjeturat, dëmtimet, dyshimet për keqpërdorim, ne bëjmë një rumbullaksim të të gjitha të gjeturave dhe i konstatojmë

në procesverbal të cilin e nënshkruajmë si anëtare të komisionit dhe paraprakisht nëse njëtori elektrik është i keqpërdorur futet në qese dhe ajo qese blombohet. Ne si komision bëjmë edhe foto dhe të gjitha të gjeturat tona i vizualizojmë, e të cilat i ruajmë si dëshmi me qëllim të dhënies si provë për ndonjë rast në gjykatë.

Deklaron se përbërja e komisionit zakonisht është nga tre anëtar nga KEDS dhe herë pas here merr pjesë edhe zyrtarja MINT-AMK, pjesëmarrje e së cilës varet nga disa faktorë apo kritere të caktuara. Fillimisht me arritjen e njëtorit në rastin konkret është bërë verifikimi, përkatësisht testimi i njëtorit elektrik përmes softuerit kompjuterik dhe tavolinës testuese dhe në bazë të rezultateve të nxjerra është parë e arsyeshme që njëtori elektrik të procedohet tutje për ekzaminime shtesë në zyrën tonë dhe në të cilën bëjmë kontrollin detal të njëtorit.

Sa i përket procesverbalit të ekzaminimit apo kontrollit detal të njëtorit elektrik tek të gjeturat ne si komision kemi konstatuar se njëtor elektrik pllombat i ka te manipuluar, të hapura dhe prap të mbyllura, nga ana e jashtme nuk kemi vërejtur dëmtime ndërsa në brendi të njëtorit kemi vërejtur se sistemi i fazës së parë L1 dhe sistemi i fazës së dytë L2 janë të eliminuara, si pasojë e kësaj njëtori elektrik nuk regjistron në këto dy faza. Shton faktin se për një njëtor ekzistojnë tri faza L1, L2, L3 dhe në rastin konkret L1 dhe L2 nuk kanë regjistruara fare energji elektrike. Sistemet e fazave L1 dhe L2 janë eliminuar përmes urave të tensionit të cilat janë të ngritura lartë duke bërë që çarku elektrik të hapet dhe energjia elektrik e cila rrjedh në njëtor të qarkullojë, mirëpo e njëjta nuk regjistrohet e po ashtu e njëjta nuk faturohet si shpenzim i energjisë, kjo vërehet edhe në bazë të fotove. Në rastin konkret energjia elektrike e sjellë nga faza L3 është regjistruar që do të thotë se njëtori elektrik e ka njësuar energjinë elektrike të shpenzuar vetëm përmes fazës së tretë L3, që do të thotë se nëse e marrim në mënyre përpjesëtimore është faturuar vetëm një e treta e energjisë së shpenzuar ndërsa dy të treta nuk janë faturuar.

Tutje deklaron se nuk kanë asnjë informacion nëse njëtorit konkret nga ekipet e terrenit ju ka bërë ndonjëherë ndonjë kontroll. Shton se nuk kanë kërkuar ndonjë informacion shtesë në lidhje me kontrollet e mundshme të njëtorit konkret elektrik nga njësitet e terrenit. Unë e di që njëtorët elektrik duhet kontrolluar herë pas here, por në çfarë intervali nuk ka njohuri.

Gjykata vlerësoi me kujdes deklarimin e dëshmitarit G.R dhe vëren se e njëjta është reale, konsistente, e besueshme dhe në harmoni me shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë dhe me përshkrimin e vendit të ngjarjes, pasi që ngjarjen e ekzaminimit të njëtorit elektrik e përshkruan në mënyrë kronologjike, besueshëm dhe tejet bindëse.



I njëjti shpjegoi në mënyrë të qartë procedurat e standardizuara të ekzaminimit të njësorëve elektrik, duke përfshirë testimin përmes softuerit kompjuterik dhe kontrollin fizik të brendshëm dhe të jashtëm të njësorit, ku njëtori elektrik futet në një qese të blombuar e pastaj komisioni i cili përbëhet prej tre anëtareve bën ekzaminimin detal të njësorit elektrik dhe bëjnë rumbullaksim të të gjitha të gjeturave, ku me pas këto të gjetura i vizualizojnë. Në rastin konkret tek të gjeturat është konstatuar se njëtori elektrik plombat i ka të manipuluar, të hapura dhe prap të mbyllura, në brendi të njësorit sistemi i fazës L1 dhe L2 janë të eliminuara, meqë rast energjia e cila rrjedh nuk regjistrohet apo faturohet. Vetëm energjia e sjell nga faza L3 është regjistruar, pra njëtori elektrik e ka regjistruar vetëm energjinë e shpenzuar nga faza L3.

Përmes provës materiale fatura: DFEHP2323601, e datës 11.07.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se njëtori elektrik është në emër të personit Adem Hasani, nga Ferizaj, po ashtu vërtetohet fakti se fatura totale e borxhit të energjisë elektrike është në vlerë prej 2,333.97 €.

Po ashtu përmes provës materiale kalkulimi i RH- Divizioni i Furnizimit- Sektori i rikthimit të humbjeve me nr.469418, është vërtetuar fakti se njëtori elektrik është në emër të pronarit Adem Hasani dhe janë konstatuar mjetet të cilat furnizohen me energji elektrike.

Përmes provës materiale procesverbali me numër: 0033289, i datës 27.12.2022, është vërtetuar se ka pasur urdhëresë për ndërrimin e njësorit elektrik për shkak të sinjalizimeve që ka treguar, ku njëtori elektrik është vendosur në një qese të blombuar dhe është dërguar për verifikim.

Përmes provës materiale procesverbali nr.2069910 i datës 05.05.2023, është vërtetuar fakti se lokali që ka shpenzuar energji elektike ka qenë në emër te personit juridik “V.C”, me pronar A.H, mirëpo punëtor i ditës së punës ka qenë G.H.

Përmes provës materiale protokollit i verifikimit të njëhsorit elektrik në Qendrën Laboratorike nr. KEDS-EL-F-LC-04, të datës 13.01.2023, është vërtetuar fakti se njësorit elektrik i është bërë verifikim nga ana e jashtme, gjatë verifikimit është vërejtur se njëtori elektrik ka kapakun e hapur më datë 17.11.2020 dhe në sistemin e fazës së parë L1 dhe L2 nuk regjistron energjinë elektrike.

Përmes provës materiale dëftesat e pagesës është vërtetuar se pronari i lokalit Adem Hasani ka bërë pagesën e energjisë elektrike me datë 09.04.2022 ,në vlerë prej 47 € , dhe më datë 11.01.2022, në vlerë prej 60 €. Pra pagues i energjisë së shpenzuar bazuar në këtë provë ka qenë A.H.

Përmes provës materiale Transaksionet e Konsumatorit, nga data 31.12.2019 deri me datë 04.06.2024, (kur janë nxjerrë transaksionet) është vërtetuar fakti se gjitha këto transaksione janë bërë nga ana e personit të quajtur A.H, si pronar i personit juridik “V.C”, me seli në Ferizaj.

Përmes provës materiale fotografitë nga vendi i ngjarjes është vërtetuar se njëtori elektrik ka pasur kapakun e hapur, dhe fazat L1 dhe L2, kanë qenë të eliminuara.

Përmes provës materiale procesverbali i ekzaminimit të njëtorit elektrik-MINT i datës 04.03.2023 me nr.27/4, është vërtetuar se njëtori elektrik i ka pllombat të manipuluar, të hapura dhe prap të mbyllura. Në brendi të njëtorit është vërejtur se sistemi i fazës L1 dhe sistemi i fazës L2 janë të eliminuara, si pasojë e kësaj njëtori elektrik nuk regjistron energji elektrike në këto dy sisteme të fazave.

Përmes provës materiale konstatimi i datës 03.12.2024, nga qendra e kalibrimit është vërtetuar se njëtori elektrik e ka të hapur dy herë kapakun kryesor dhe atë njëherë me datë 17.11.2020 ora 10:27:43 dhe hera e dytë më 17.11.2020 ora 10:36:21.

Andaj bazuar në dëshminë e dëshmitareve, si dhe provat materiale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar në tërësi se në njëtorin elektrik me numër 62267292, ka pasur ndërhyrje dhe atë janë larguar fazat L1 dhe L2 dhe atë në dy herë me datë 17.11.2020, ora 10:27 dhe 10:36.

### **Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit**

Gjykata vlerëson se mbrojtja e të akuzuarit G.H, ishte konsistente dhe karakterizohet me mbrojtje të logjikshme, të natyrshme, për më tepër mbrojtja e tij është në harmoni dhe e mbështetur me provat tjera të prezantuara, si dhe me dëshminë e dëshmitarëve.

I akuzuari në mbrojtjen e tij nuk e mohon faktin se njëtori elektrik nuk ka qenë në gjendje të mirë në momentin kur e kanë marrë me qira lokalit, por shton se nuk ka qenë në dijeni me problemet që i ka pasur njëtori, i njëjti mohon faktin se ta ketë prekur ose intervenuar në atë njëtor, pasi që ai vetëm është shfrytëzues i lokalit të cilin e ka me qira, e të cilin lokal e kanë marrë me qira së bashku me vëllezërit e tij dhe vetëm nga data 04.05.2024, e shfrytëzon vetëm ai. Për gjykatën kjo deklaratë ka gjetur mbështetje edhe në provat materiale siç janë fatura: DFEHP2323601 e datës 11.07.2023, e cila është në emër të pronarit të lokalit A.H, dhe jo në emër të të akuzuarit.

Gjykata ka vlerësuar se në asnjë mënyre nuk është vërtetuar aspekti subjektiv i veprës penale për të cilën i akuzuari ngarkohet. Mungesa e provave që do të dëshmonin drejtpërdrejt ndërhyrjen apo manipulimin e njëtorit elektrik nga ana e të akuzuarit e ka bërë të pamundur konstatimin e përgjegjësisë penale të tij për këtë vepër penale. Duke analizuar të gjitha këto elemente, gjykata ka arritur në përfundimin se nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari G.H ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, pasi që i akuzuari G.H, nuk ka qenë i vetmi person që e ka shfrytëzuar lokalit e marrë me qera. Kanë qenë tre persona-tre vëllezër, ato që kanë punuar me ndërrime në atë lokal. Po ashtu i akuzuari së bashku me vëllain e tij kanë qenë personat të cilët e kanë bërë marrëveshjen verbale me pronarin e lokalit për qiranë. Andaj bazuar në të gjitha këto gjykata ka konstatuar se nuk është vërtetuar në asnjë mënyrë që ka qenë pikërisht i akuzuari personi i cili ka bërë ndërhyrjen e njëtorit elektrik, pasi që siç ka deklaruar edhe i akuzuari në mbrojtjen e tij ka rastisur të ketë qenë orari i tij i punës ditën kur është përpiluar procesverbali nga ana e KEDS-it.

Andaj, nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë *“in peius”* ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë *“in favorem”* ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

### **Baza ligjore**

Sipas nenit 314 paragrafi 1 të KPRK-së, për t’u kryer kjo vepër penale parashihet:

**Paragrafi 2.** Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Nga kjo dispozitë ligjore, forma themelore e kësaj vepre penale ekziston kur kryesi i veprës penale (në rastin konkret kryesi), me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime me të cilat shmang pagesën për shërbime të tilla.

Sipas vlerësimit të gjykatës, në rastin konkret elementet e kërkuara sipas dispozitës ligjore të nenit 314 paragrafi 1 të KPRK-së, bazuar në deklaratimet e të akuzuarit, deklaratimet e dëshmitarëve si dhe fotografive, nuk janë përmbushur dhe atë për faktin se me asnjë provë të vetme nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari me anë të veprimeve të tija ka siguruar shërbime me të cilat iu është shmangur pagesës për shërbimet e tilla, e që në këtë rast nuk është përmbushur forma themelore e kësaj vepre penale, pasi që siç është cekur edhe më lartë gjykata nuk ka mundur të vërtetojë aspektin subjektiv të kryesit të kësaj vepre penale edhe pse në njehsor ka pasur ndërhyrje.

### **Kërkesa pasurore-juridike dhe shpenzimet e procedurës**

Në kuptim të nenit 462 paragrafi 3, të KPPK-së, e dëmtuara KEDS-Distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore–juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 453 paragrafi 1, të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj gjykate.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**  
**2024:175257, datë 12.02.2025**

**Zyrtare ligjore**

Egzona Livoreka

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

Fitore Krivanjeva-Daci

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.